



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802144/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandim për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të akomoduar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Korçë.*

Drejtuar: **Z. Sotiraq FILO**
Kryetar i Bashkisë

KORCË

Znj. Luneda SUFALI
Drejtoreshë e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror

TIRANË

Për dijeni: **Zj. Arjana SKLLAVI**
Drejtoreshë e Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit

KORCË

Në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues në promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Avokati i Popullit ka si prioritet të tij, promovimin dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti ynë është shtrirë në disa aspekte konkrete të mbrojtjes së këtyre personave, me një qasje proaktive dhe të dedikuar, duke zhvilluar në mënyrë

të vazhdueshme me iniciativë, inspektime në Qendrat e Zhvillimit Rezidencial në të gjithë vendin, ku janë të akomoduar persona me aftësi të kufizuara.

Një nga këto inspektime është zhvilluar nga përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 25.10.2018, në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Korçë.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë akomoduar në këtë qendër rezidenciale, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë, si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesen e institucionit dhe shefen e financës, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, sipas standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Qendrës së Zhvillimit Rezidencial), ku ofrohen shërbime për personat me aftësi të kufizuara.
- ***Së katërti***, komunikimi me disa nga personat me aftësi të kufizuara, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Korçë, të cilët ishin me prapambetje të lehtë mendore.

Profili i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Korçë

Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, Korçë, është një qendër rezidenciale për personat me aftësi të kufizuar, nën administrimin e Bashkisë Korçë dhe me mbështetje financiare të garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror.

Kjo qendër është përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës dhe raporton për problematika të ndryshme pranë Bashkisë Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror. Qendra e Zhvillimit ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për kujdes afatgjatë, dhe mbajtja e të cilëve në familje është vlerësuar si e papërshtatëshme, ose e pamundur.

Organizimi dhe funksionimi i kësaj qendre së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të qendrës, e cila është e afishuar në ambjentet e saj.

Në funksion të organizimit administrativ të kësaj qendre, Këshilli Administrativ është organi përgjegjës për Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Korçë, i cili ka miratuar edhe Rregulloren e Brendshme të saj.

Ai përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë:

- Drejtor
- Punonjës Social
- Financier
- Specialiost
- Edukator
- Prind
- Donatore.

Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdues, monitorohet nga Bashkia Korçë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë.

Monitorimi realizohet si proces edhe nga inspektimet e kryera nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore, Instituti i Higjienës, Agjencia Kombëtare e Ushqimit etj.

Në këtë qendër rezidenciale, aktualisht po zbatohet projekti; ”Për ngritjen e ateliesë së hekurosjes”, nga ana e shoqatës zviceriane “ASED”.

Numri i përfituesve nga shërbimet e qendrës

Nga konstatimi paraprak u evidentua se, në këtë qendër mund të akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona me aftësi të kufizuar, me diagnoza dhe grup mosha të ndryshme, mbi moshën 25 vjeç.

Kapaciteti i qendrës për ofrimin e shërbimeve është për 38 persona. Gjatë inspektimit u konstatua se në të trajtoheshin 36 persona, të cilët ishin të ekzaminuar me ç'rregullime të lehta dhe të moderuara të aftësisë mendore, sikundër trajtoheshin edhe të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë.

Për çdo përfitues të shërbimeve të qendrës ishte hartuar plani i kujdesit shëndetësor, sipas nevojave të tyre specifike.

Shërbimi mjekësor realizohej nga një mjek me kohë të pjesëshme/psikiatër, i cili shkonte çdo ditë në qendër. Rekomandimet për kryerjen e analizave dhe mjekimet jepeshin nga mjeku i familjes dhe plotësoheshin nga mjeku specialist. Për sëmundjet kronike, mjekimi jepej dy herë në vit, por në bazë të gjendjes shëndetësore, personave të trajtuar në këtë qendër iu jepej rekomandimi edhe çdo muaj.

Një pjesë e medikamenteve me të cilat trajtoheshin personat përkatës me aftësi të kufizuar ishin të rimbursueshme, ndërsa pjesa tjetër mbulohej me fondet e kësaj qendre.

Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të kësaj qendre përbëhet nga 23 punonjës me kohë të plotë, si dhe nga 1 punonjës i punësuar me kontratë, nga ana e Shërbimit Social Shtetëror.

Për numrin e parashikuar maksimal të përfituesve (38 persona), të cilët mund të marrin shërbime në këtë qendër zhvillimi kujdesen 9 kujdestarë (8 kujdestare dhe 1 specialist edukator), personel ky që ka mbi 20 vjet përvojë punë përkujdesjeje në këtë qendër.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale, e cila është edhe përgjegjëse e sektorit social.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet çdo vit nga drejtuesja e institucionit. I gjithë stafi është i trajnuar në teknikat dhe çëshjtjet e komunikimit me përfituesit e shërbimeve të ofruara.

Megjithatë nga konstatimet e kryera gjatë inspektimit, gjykojmë se numri i punonjësve që ofrojnë shërbime shoqërore në këtë qendër është i pamajftueshëm, gjë që ndikon edhe në cilësinë e shërbimit të ofruar, ndaj

edhe nevojitet shtimi i këtij numri me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara.

Ambjentet e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Korçë

Godina ekzistuese e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Korçë, ishte rikonstruktuar në vitin 1999.

Në katin e parë të kësaj godine gjendeshin dhomat e fjetjes, administrata, salla e logopedisë, e fizioterapisë, magazina, lavanderia, tualetet si dhe një mence.

Në katin e dytë gjendeshin disa dhoma të tjera fjetjeje, dy taulete dhe dy menca.

Ambjentet okupacionale ishin të mirëmbajtura, me shumë punime, vizatime të bëra nga vetë përfituesit e shërbimeve të ofruara, gjë që tregonte për punën e përkushtuar të stafit të qendrës.

Tualetet, të cilat ndodheshin në katin e parë të godinës, ishin të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e qendrës, si dhe ishte vendosur edhe “kutia e ankesave”, ku depozitoheshin ankesat e mundshme ndaj personelit të qendrës për mënyrën e komunikimit apo të ofrimit të shërbimit ndaj përfituesve. Sipas rregullores, përfituesit e shërbimeve të ofruara, të cilët janë me probleme të lehta mendore, ankesat i tyre duhet ti paraqesin te punonjësja sociale, ose te drejtuesja e qendrës.

“Kutia e ankesave” hapej një herë në muaj, nga përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Korçë.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridoret e qendrës.

Sikurse e evidentuar gjatë inspektimit nuk u paraqiten probleme për furnizimin me artikujt hotelerike. Ky furnizim përgjithësisht realizohej nga donacione të ndryshme, si dhe nga Bashkia Korçë.

Furnizimi me detergjentë realizohej me tenderim, një herë në vit.

Ambjenti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba industriale, frigorifer etj. Ndërkohë, kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer.

Kuota ushqimore në kohën e inspektimit rezultoi se ishte rritur dhe se kapte vlerën prej 520 (pesëqind e njëzet) lekësh në ditë, për çdo përfitues të shërbimeve të ofruara.

Magazina ishte në gjendje shumë të mirë. Artikujt ushqimore, hotelerike, veshmbathjet, ishin të sistemuara nëpër dhoma të veçanta.

Sistemi i ngrohjes dhe i ftohjes funksiononte me kaldajë, sistem ky i instaluar që në vitin 1999. Në çdo dhomë dhe nëpër korridore ishin të vendosur kaloriferë muri.

Oborri përreth qendrës ishte relativisht i madh dhe përfituesit e shoqëruar nga stafi i qendrës kalonin shumë kohë jashtë, në ajër të pastër, veçanërisht kur koha ishte e mirë.

Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni që u mor gjatë inspektimit u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme, në varësi të moshës dhe dëshirave të përfituesve të shërbimeve të ofruara. Aktivitetet më të shumta organizoheshin në stinën e verës, të tilla si, pushime në qytetin e Pogradecit, vizitë në Dardhë, etj.

Përfituesit e shërbimeve të ofruara rezultoi se gjatë qëndrimit në Qendër, kryenin punime dore, me letra, punime me materiale të riciklueshme etj.

Nga kontakti me personelin e qendrës na u pohua fakti se, ata vizitoheshin rrallë nga të afërmit e tyre. Më konkretisht vizitoheshin vetëm dy përfitues të shërbimeve të ofruara, ndërsa të tjerët ishin braktisur nga familjarët dhe të afërmit e tyre.

Të gjithë përfituesit që strehoheshin që këtë qendër u treguan shumë të dashur dhe miqësorë me përfaqësuesit e institucionit tonë. Një tregues i dukshëm gjatë këtij inspektimi ishte përkushtimi i stafit ndaj përfituesve.

Problematikat e konstatuara:

- Rezulton se në organikën e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Korçë nuk është parashikuar pozicioni i psikologut, si pjesë përberëse e kësaj të fundit . Përfshirja në organikë e pozicionit të psikologut konsiderohet thelbësor për të mundësuar trajtim të përshtatshëm dhe të dedikuar për këtë kategori specifike të përfituesve, të cilët karakterizohen nga nevoja permanente për praninë e një psikologu përgjatë gjithë kohëzgjatjes së akomodimit të tyre në këtë Qendër.
- Konstatohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet e përkujdesit shëndetësor për përfituesit e shërbimeve të kësaj natyre, të akomoduar në këtë Qendër. Konkretisht, rezulton se numri i kujdestarëve të punësuar

për ofrimin e shërbimeve nuk është i mjaftueshëm (vërehet një shpërndarje e tyre prej 2 (dy) kujdestarësh për çdo turn). Sjellim në vëmendje se kjo problematikë është tejet shqetësuese, po të kemi parasysh faktin se kategoria e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen në këtë Qendër janë natyrshëm mbartës të shumë probleme sociale dhe atyre shëndetësore.

- Përsa i përket infrastrukturës së ndërtesës vërehet gjendja tejet e amortizuar e dritareve deri në masën që dëmtonte funksionalitetin normal të tyre, e më konkretisht u vu re mungesa e dorezave në shumicën prej tyre apo pamundësia e tyre për t'u mbyllur tërësisht. Të njëjtat problematika konstatohen edhe për dyert të cilat shfaqin të njëjtin nivel amortizimi.
- Konstatohet mungesa e pajisjeve të tilla si lavatriçe dhe tharëse profesionale, pajisje këto të cilat konsiderohen të domosdoshme (kriter minimal) për mbarëvajtjen e aktivitetit specifik të kësaj Qendre, në funksion të përmbushjes së standartve në ofrimin e shërbimeve përkatëse të përkujdesjes. Nga informacioni i përcjellë gjatë procesit të monitorimit u konstatua se kategoria e përfituesve e akomoduar në këtë Qendër kishte nevojë të vazhdueshmë për ndërresa, sidomos përgjatë stinës së dimrit, e cila në këtë zonë të vendit është shumë e ftohtë.
- Konstatohet se pajisjet e kaldajës ishin amortizuar duke mos mundësuar teknikisht ngrohjen maksimale të ambienteve të godinës. Rezultonte se nga ana e strukturave administruese të Qendrës ky problem është adresuar me anë të një shkresë në Bashkinë Korçë, shkresë në të cilën parashtrohej kërkesa për vendosjen e një sistemi të ri të kaldajës. Vërehet se deri momentin e kryerjes së monitorimit, kjo problematikë megjithëse e adresuar në institucionin përgjegjës, nuk kishte marrë ende zgjidhje.
- Konstatohet se, krevatet ekzistues që ndodhen në godinën e Qendrës, nuk janë të përshtatura në funksionalitet për përfituesit që bëjnë pjesë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, përkatësisht atyre paraplegjike e tetraplegjike. Ky fakt përben burim për gjenerimin e vështirësive/problematikave konkrete jo vetëm për këtë kategori përfituesish, por edhe për stafin e Qendrës i cili i shërben përfituesve të kësaj kategorie.
- Së fundmi, konstatohet se stafi i punësuar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Korçë, nuk kishin ndjekur trajnimin përkatës për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetesës për personat me aftësi të kufizuara në Institucionet Rezidenciale, duhet të jetë në fokusin e punës së këtyre institucioneve. Sa më sipër, në funksion të jetesës së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore.

Duke marrë në konsideratë konstatimet e renditura më sipër, Avokati i Popullit gjykon se pavarësisht punës rigoroze të bërë në këtë institucion, kërkohet një angazhim më i madh dhe një bashkëpunim më i mirë ndërinstytucional, ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara të akomoduar në Institucionet Rezidenciale.

Për këtë qëllim, për t'iu përgjigjur nevojave të aftësimit dhe zhvillimit të personave me aftësi të kufizuara, në mbështetje të nenit 21, të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave përkatëse për shtimin në organikën e Qendrës të pozicioneve shtesë të punës, përkatesisht, kujdestarit (3), psikolog (1).
- Vijimin e ndjekjes nga strukturat administruese të Qendrës me Bashkinë Korçë të problematikës së instalimit të një sistemi të ri kaldaje si pasojë e amortizimit të skajshëm të atij ekzistues dhe vendosjen e një sistemi të ri brenda një afati optimal, për të mundësuar teknikisht ngrohjen maksimale të ambienteve të godinës.
- Marrjen e masave përkatëse për përmirësimin e infrastrukturës së ndërtesës, konkretisht zëvendësimin e dritareve dhe dyerve të amorizuara të Qendrës me dyer e dritare të reja, në funksion të përmbushjes së standardeve në ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes për kategorinë e përfituesve që trajtohen në këtë Qendër.
- Marrjen e masave përkatëse për pasjisjen e Qendrës përkatesisht me lavatriçe dhe tharëse profesionale, pajisje këto të cilat konsiderohen të domosdoshme (kriter minimal) për mbarëvajtjen e aktivitetit specifik të kësaj Qendre, në funksion të përmbushjes së standartve në ofrimin e shërbimeve përkatëse të përkujdesjes.

- Marrjen e masave për kryerjen nga stafi i punësuar i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Korçë, të trajnimit përkatës për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave personave me aftësi të kufizuara, lutemi shqyrtimin e rekomandimeve të sipërcituar.

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA